

Njihuni me ekipin NTPN Martha-CARE

Konsulentët



Craig Knott



Jenny
Pallawela



Beatrice
Allnutt



Javier
Gavela

Infermierët e mbështetjes së familjes



Kylie Lyons



Anne
Dowson



Annie
Bruce

Martha-CARE

Asistencë në komunikim dhe kujdes i shpejtë intensiv



Informacion për familjarët dhe kujdestarët

Një projekt pilot i North Thames Paediatric Network





Çfarë është North Thames Paediatric Network?

Ne jemi një ekip që mbështet të gjitha spitalet që ofrojnë shërbime për fëmijë brenda Londrës, në veri të lumit Tamiz, dhe gjithashtu disa spitale jashtë Londrës në pjesën lindore. Ne duam që të gjithë fëmijët që trajtohen në këto spitale të kenë qasje të barabartë në kujdes të sigurt dhe me cilësi të lartë.



Çfarë është Martha-CARE?

Martha-CARE është një mënyrë tjetër për të marrë ndihmë nëse jeni të shqetësuar për fëmijën tuaj në spital. Është një shërbim i ofruar nga North Thames Paediatric Network (NTPN) dhe është pjesë e një projekti më të madh që menaxhohet nga NHS, i quajtur **"Martha's Rule" (Rregulli i Martha-s)**.



Çfarë është Rregulli i Martha-s?

Ndoshta keni dëgjuar për Rregullin e Martha-s në lajme ose keni parë postera në spital. Ndonjëherë quhet edhe si *"Call for Concern"* (*"Thirrje për shqetësim"*). Kjo vjen si pasojë e një rasti ku një vajzë me emrin Martha u sëmur rëndë në spital dhe shqetësimet e familjes së saj për të nuk u dëgjuan. Prindërit e Martha-s donin të siguroheshin që të gjitha familjet dhe kujdestarët të kenë mundësi të marrin ndihmë dhe shqetësimet për fëmijën e tyre të dëgjohen.



Si funksionon Martha CARE ?

Martha-CARE është një mënyrë ndryshe për të marrë ndihmë në spital nëse ende ndiheni të shqetësuar pas shfrytëzimit të Rregullit të Martha-s ose Thirrjes për shqetësim. Për këtë është një numër telefoni i një ekipi tjetër, jashtë spitalit ku ndodheni. Ekipi njihet me emrin "Children's Acute Transport Service" (CATS) (Shërbimi i transportit të kujdesit intensive për fëmijë). CATS është një shërbim i veçantë që mbështet spitalet që kanë fëmijë shumë të sëmurë. Mund të kërkonit nga doktori ose infermiera të telefonojë Martha-CARE. Numri është në dispozicion 24/7.



Çfarë ndodh gjatë telefonatës?

Do të keni mundësi të flisni me konsulentin e CATS pasi ekipi juaj lokal t'u ketë treguar atyre për fëmijën tuaj dhe për atë që ka ndodhur në spital. Do të pyeteni lidhur me shqetësimet tuaja dhe pse ju është dashur të bëni një telefonatë drejt Martha-CARE. Gjatë orarit të zakonshëm të punës, gjatë telefonatës do të jetë edhe një infermiere për mbështetje të familjes që do t'ju ndihmojë. Nëse në kujdesin e fëmijës suaj është përfshirë një ekip specialistësh, atëherë ai mund të jetë gjithashtu pjesë e kësaj telefonate. Ne do të përpiqemi të punojmë me ju dhe doktorët e infermierët e fëmijës suaj për t'ju ndihmuar me shqetësimet tuaja.



Çfarë ndodh më tej?

Infermierët e mbështetjes së familjes pranë Martha-CARE do t'ju kontaktojnë rreth 4-6 javë pasi të keni përdorur shërbimin Martha-CARE, për të kontrolluar si jeni ju dhe fëmija juaj dhe për të parë çfarë mendimi keni për shërbimin tonë. Ne duam të sigurohemi që po ofrojmë kujdesin më të mirë, prandaj dëshirojmë vërtet të dimë mendimin tuaj.



Ku mund të marr më shumë informacion?

Nëse keni nevojë për më shumë informacion, ju lutemi, flisni me infermieren ose doktorin tuaj. Ose faqet e mëposhtme të internetit kanë më shumë informacion:

NHS England - <https://www.england.nhs.uk/patient-safety/marthas-rule/>
NTPN - Martha's Rule <https://ntpn.co.uk/marthas-rule-2/>